



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-047

Prishtinë, më 23 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 JANAR 2012**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Duda Balje dhe Sasha Millosavleviq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

**Nga Zyra e Presidentit:** Amir Haradinaj dhe

**Nga OSBE:** Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 janar 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

#### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 janar 2012**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 janar 2012, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 26 janar 2012, me këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronat e paluajtshme.
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare, jo bankare.
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat korporative.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që nëse deri më 24 janar 2012, përgatitet edhe ndonjë raport nga komisionet parlamentare lidhur me projektligjet për shqyrtim të parë, mund të radhiten për shqyrtim në mbledhjen plenare më 26 janar 2012.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Programi legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2012**

Kryesia, pasi shqyrtoi Programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2012, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Ngarkohen komisionet parlamentare që, mbi bazën e Programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2012 dhe të propozimeve të veta, t'i hartojnë planet e punës periodike dhe Programin e punës së komisioneve për vitin 2012.
2. Ngarkohet Sekretaria e Kuvendit që, në bazë të Programit legjislativ të Qeverisë dhe të planeve të punës së komisioneve parlamentare, ta hartojë Propozim-Programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet mbledhjes plenare për miratim.

#### **3.2 Formimi i Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë**

Kryesia, pasi shqyrtoi pikën e lartpërmendur lidhur me formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, mori këtë

#### **V e n d i m**

##### **Për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë**

1. Anëtarë të Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë emërohen: Mufera Shinik, Behar Selimi, Eqrem Kryeziu, Liburn Aliu, Teuta Haxhiu, Suzana Novobërdaliu dhe Biserka Kostiq.
2. Mufera Shinik emërohet kryetare e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë.
3. Nënkryetari i Grupit të Miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë caktohet nga radha e këtij grupi, si dhe një sekretar nga radha e stafit të Administratës së Kuvendit.

### **3.3 Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi**

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të realizuar në Turqi, prej 25 deri më 28 dhjetor 2011.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.